




MOBIAK[®]
FIREFIGHTING • GASES • MEDICAL est. 1977

PROFILI I SHOQËRISË

Profili i shoqërisë

MOBIAK S.A. U themelua në vitin **1977** dhe aktualisht është shoqëria më e madhe në Greqi, por edhe një nga shoqëritë me rritjen më të shpejtë në Evropë në fushën e pajisjeve zjarrfikëse dhe mjekësore. Për më shumë se **46 vite**, aktivitetet e MOBIAK-ut janë fokusuar në zhvillimin e **5 fushave kryesore**:

- ▶ **MOBIAKFIRE:** Ndërtim, montim, tregtim të pajisjeve zjarrfikëse, si dhe ritestim i fikëseve të zjarrit
- ▶ **MOBIAKCARE:** Prodhimi dhe tregtimi i pajisjeve mjekësore dhe produkteve të kujdesit shtëpiak, riparimi i pajisjeve mjekësore dhe objekte laboratorike për gjumë
- ▶ **MOBIAKGAS:** Prodhimi dhe ambalazhimi në shishe i gazeve mjekësore dhe industriale
- ▶ **MOBIAKTRAINERS:** Trajnim profesional në fushën e sigurisë nga zjarri dhe parandalimit nga një personel i kualifikuar. Funksionimi i një qendre konferencash/trajnimi.
- ▶ **MOBIAKRECYCLE:** Riciklimi dhe menaxhimi i mbetjeve

Kursi i shpejtë dhe i suksesshëm i MOBIAK-ut për gati gjysmë shekulli bazohet në katër parime: **Cilësi, shumëllojshmëri, çmime konkurruese dhe stoqe të mëdha - Dërgesë e shpejtë..** Këta katër parametra përbëjnë motivet e forcës punëtore të saj për çdo veprim apo vendim.

Në shoqëri vlerësohen shumë kreativiteti dhe dinamika e individit, duke inkurajuar iniciativat e punonjësve dhe lirinë e tyre të shprehjes. **Forca punëtore e MOBIAK-ut** çon drejt zgjedhjeve të lehta në mënyrë të guximshme dhe pa kompromis, duke ndjekur me besnikëri vlerat që e çuam në majë **MOBIAK-un**, duke krijuar një të ardhme më të sigurt dhe më të mirë për të gjithë.

MOBIAK-u po përmirëson vazhdimisht produktet dhe shërbimet e saj, duke respektuar gjithmonë filozofinë e saj...
"Vlerësimi i sigurisë... Investimi në cilësi!"



Objektet



WWW.MOBIAK.COM

Objektet qendrore të shoqërisë ndodhen në Chania, në një zonë private me një sipërfaqe prej **32.000 m²**. Në vitin 2021, stafi drejtues përfundoi investimin për të krijuar një mjedis të ri pune ku u transferuan drejtuesit e tij ekzekutivë. Kjo zonë përbëhet nga 85 zyra të reja duke krijuar kështu mundësinë për vende të reja pune dhe zgjerimin e burimeve njerëzore.

Gjithashtu, ambientet e reja kanë katër salla konferencash, të madhësive të ndryshme, që përdoren për seminarët e trajnimit të organizuara në ambientet e shoqërisë, si dhe ekspozitat e produkteve të saj zjarrfikëse dhe mjekësore.

Një tjetër zgjerim është kryer vitet e fundit për magazinat qendrore dhe qendrat e shpërndarjes, duke krijuar kështu infrastruktura të reja dhe moderne, me makineri të modernizuara dhe staf me përvojë, të aftë për të menaxhuar stoqet me shumicë - super shumicë. Kombinimi i përshtatshëm që shoqëria të jetë në gjendje të sigurojë stoqe të larta dhe dërgesa të shpejta.

Me një forcë punëtore totale prej më shumë se **200** personash dhe e kombinuar me makineritë e teknologjisë më të fundit që disponon, **MOBIAK-u** është në gjendje të garantojë produkte dhe shërbime të cilësisë së lartë.



Zhvillimi dhe certifikatat e shoqërisë



Një tjetër gjë që kontribuoi në progresin e jashtëzakonshëm të viteve të fundit është pozicioni strategjik i shoqërisë në zemër të Mesdheut. **MOBIAK-u** ka arritur jo vetëm të ketë një rrjet aktiv partnerësh në Greqi që e kalon numrin 500 shitës me shumicë, por edhe të eksportojë në mbarë botën, duke pasur një rrjet shitjesh ndërkombëtare në më shumë se **110** shtete, në Ballkan, Evropë, SHBA, Kanada, Lindjen e Mesme, Australi, Zelandë të Re, Afrikë dhe Azi.

Angazhimi i shoqërisë ndaj vizionit të saj fillestar për cilësinë e përgjithshme të shkëlqyer të produkteve dhe shërbimeve të saj, bëri që **MOBIAK-u** të merrte një rol udhëheqës në këtë fushë. Kjo gjë vërtetohet nga njohja mbarëbotërore nga organet ndërkombëtare të certifikimit që japin vlerësime dhe certifikime që shumë pak shoqëri në këtë industri i kanë.

Karakteristikat bazë

- ▶ Produkte të certifikuara të çdo kategorie të pajisjeve zjarrfikëse, mjekësore dhe të gazit
- ▶ Produkte dhe shërbime me cilësi të lartë
- ▶ Një gamë e gjerë që mbulon çdo nevojë në fushat e saj të veprimtarisë
- ▶ Certifikime ndërkombëtare për Evropën, Azinë, Lindjen e Mesme, SHBA-në, Australinë dhe Kanadanë
- ▶ Stok i madh për furnizim me kushte joshëse dërgese
- ▶ Personalizimi i produkteve për të përmbushur kërkesat e veçanta të çdo tregu ose partneri
- ▶ Shërbim i shpejtë që i mundëson partnerëve tanë të përmbushin kërkesat e tyre në të njëjtën ditë
- ▶ Mbështetje teknike dhe trajnim për projektimin dhe instalimin e sistemeve të zjarrfikjes
- ▶ Mbështetje për shërbimin e pajisjeve mjekësore në 3 pika shërbimi në të gjithë Greqinë

CERTIFIKIMI NDËRKOMBËTAR ORGANET DHE STANDARDET



Portable and Mobile Fire
Extinguishers
ABC Dry Powder Series
Foam Series
CO₂ Series



ABC Dry Powder (portable
and mobile)
Foam Series
CO₂ Series
Kitchen Series



2014/68/EU (new PED)
Conformance to Pressure
Equipment Directive
[substantially amending
97/23/EC, former PED]



Conformance with EU
directive:
2010/35/EU (TPED)
applies for cartridges,
gas cylinders intended as
transportable equipment
[updating the provisions of
Directive 1999/36/EC,
former TPED]



BS EN3-7
KM 594785
Portable Fire Extinguishers



BS EN3-7
KM 675727
Portable Fire Extinguishers



BS EN1866
KM 597953
Mobile Fire Extinguishers

BS EN3 from BSI (UK) KITEMARK
ABC Dry Powder Series Extinguishers
Foam Series Extinguishers
Water Series Extinguishers
CO₂ (Alloy & Aluminum Steel Series Extinguishers)
Powder, Foam and CO₂ Mobile Extinguishers
Kevlar Extinguishers



Italian Ministry Approval Foam,
Powder and CO₂ Fire
Extinguishers Portable and
Mobile



Conformance to
Standard EN3
for Portable
Fire Extinguishers



ABC Dry Powder
Foam Series
CO₂ Series
Kitchen Series
Smoke Detector



BS EN1869:1997
KM608739
Fire Blankets

Size
1.1m x 1.1m
1.2m x 1.2m
1.2m x 1.8m



UK Merchant Shipping
(Marine Equipment)
Regulations SI 2016/1025,
as amended by
SI 2019/470 & MSN 1874
(M+F) Amendment 4



Stored Pressure & Internal
Cartridge
6Lt Foam
9Lt Foam

EN1866

Conformance to
Standard EN1866 for
Mobile
Fire Extinguishers

UNI 9492

Conformance to Italian
Standard UNI9492 for
Mobile Fire Extinguishers



MPA EN3 from Germany
ABC Dry Powder Series Extinguishers 6Kg
Foam Series Extinguishers 6Lt / 9Lt
Mobile Foam and Powder Series Extinguishers
50Kg / Lt Water Mist fire extinguishers
2Lt / 6Lt / 9Lt



Powder, CO₂ &
Wet Chemical
Extinguishers Series
Fire Hoses Landing Valves
Gate Valves
Indicator Posts
Check Valves
Indicating Butterfly Valves
Dry Barrel Hydrants
Models



UL standards of
Canada
Powder
Fire
Extinguishers
Series



directive 2014/90/EU

MED Extinguishers For Marine Use

MIRTEC Series - 0437

2Kg Powder A1/3 38	6Lt Foam	2Kg CO ₂
3Kg Powder	9Lt Foam	5Kg CO ₂
6Kg Powder / A1/3 2	6Lt ABF wet Chemical	10Kg CO ₂
9Kg Powder	9Lt ABF wet Chemical	30Kg CO ₂
12Kg Powder	25Lt Foam	
25Kg Powder	50Lt Foam	
50Kg Powder	100Lt Foam	
100kg Powder		

BSI Series - 2797

6Kg Powder Fire Extinguisher
9Kg Powder Fire Extinguisher
9Lt Foam Fire Extinguisher
9Lt Water Fire Extinguisher
CO₂ 5Kg Fire Extinguisher (Alloy Steel)



S 318003
Fixed HFC-227ea
Fire Extinguishing
System



Partner for progress

1Kg Powder 6Lt Foam AB
2Kg Powder 9Lt Foam AB
6Kg Powder 2Lt Foam ABF
9Kg Powder 6Lt Foam ABF
12Kg Powder 9Lt Foam AB
2Lt Lithium Fire Extinguisher
6Lt Lithium Fire Extinguisher
9Lt Lithium Fire Extinguisher
2Kg CO₂ Hose reels
5Kg CO₂



Portable & Mobile
Foam & Powder &
Portable CO₂
Fire Extinguishers



Member of the FM Global Group

Gate Valves
Indicator Posts
Check Valves
Indicating Butterfly Valves
Dry Barrel Hydrants Models



BENOR: Belgium Approval
Foam, Powder and CO₂
Fire Extinguishers
Portable and Mobile



Swiss Approval
Foam, Powder and CO₂
Fire Extinguishers
Portable



Turkish Standards
Portable Foam, Powder
and CO₂ Fire Extinguishers

IMO RES, MSC

International Maritime Organization,
Maritime Safety Committee



Katasztrófavédelmi
Kutatásintézet

Hungary State Approval Body
Portable and Mobile Foam,
Powder and Portable CO₂
Fire Extinguishers



DNV EN3 License for Norway
Portable Extinguishers



LPCB from UK
Fire Hose reels
CE & EN671-1
Gate valves
Hose Couplings
Branchpipes
Inlet Breechings
Landing valves



French Audit Notify and
Accredited Laboratory
NF Fire extinguishers Series



MEMBER
2020-2023

Membership at National Fire
Protection Agency of U.S.A.



PR21-4902638-A
PR21-4902638-B

Certificate of Service Recognition
- Fire Extinguishing Systems
- Self Contained Breathing Apparatuses

ELOT

Greek Organisation for Standardization

SOLAS

The International Convention for the
Safety of Life at Sea.



RoHS

EU legislation restricting the use of
hazardous substances in electrical
and electronic equipment Directive.

EN1869:2019

Standard for the Certification of Fire
Blankets



Lithuanian Approval
Foam, Powder and CO₂
Fire Extinguishers
Portable



RINA

2021/XH/01/2768

Certificate of Service Recognition
- Fire Extinguishing Systems
- Self Contained Breathing Apparatuses



ΕΘΝΙΚΟ ΚΕΝΤΡΟ ΑΞΙΟΛΟΓΗΣΗΣ
ΤΗΣ ΠΟΙΟΤΗΤΑΣ & ΤΕΧΝΟΛΟΓΙΑΣ
ΣΤΗΝ ΥΓΕΙΑ Α.Ε.
NATIONAL EVALUATION CENTER
OF QUALITY & TECHNOLOGY
IN HEALTH S.A.

CE Certificate for Mobiak's
Respiratory Devices



SCIENTIFIC AND RESEARCH
CENTER FOR FIRE PROTECTION
STATE RESEARCH INSTITUTE



Cert No 37939

Certification of Quality
Management System
according to ISO9001:2015



— I Net —

HEALTH & SAFETY MANAGEMENT SYSTEM
ISO 45001:2018

Certificate of Health & Safety
Management System
ISO 45001:2018



Certification Environmental
Management System
according to ISO14001:2015



Information Security System
according to ISO 27001:2013



ISO-13485 Quality Management
Certificate Medical Technology



Distribution of Medical Devices

Russian Register

20.01141.295
Certificate of Service Recognition

MOBIAKFIRE

PAJISJE ZJARRFIKËSE

Për sa i përket Sektorit të Zjarrfikësve të Shoqërisë, punonjësit e **MOBIAK-ut** janë vazhdimisht në kërkim të zgjidhjeve dhe propozimeve të reja, më të mira dhe më të sigurta për partnerët e tyre.

Si pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm të saj, shoqëria, në vitin 2005, zbatoi një program të madh investimi në ambientet e saj qendrore në Chania, investim i cili përfshinte instalimin e një linje të plotë montimi robotik për fikjen e zjarrit dhe ndërtimin e një ndërtese të re 2500 m² për ta vendosur atë dhe selinë e stafit drejtues të saj. Gjithashtu, po në të njëjtin vit u realizua edhe zgjerimi i hapësirës së magazinimit të lëndëve të para dhe produkteve të gatshme për përdorim.

Më pas, në vitin 2019, **MOBIAK-u** bleu një hapësire magazinimi prej 7000 m² në Aspropyrgos, Atikë, dhe organizoi qendrën e shpërndarjes së Selanikut prej 5000 m², për të rritur kapacitetin e magazinimit.


Në 2021, **MOBIAK** përfundoi një tjetër zgjerim të ambienteve të saj qendrore, duke rritur kështu kapacitetin e prodhimit dhe magazinimit dhe duke arritur mundësinë e sigurimit të stoqeve në sasi të mëdha të produkteve për shitje. Tashmë ambientet qendrore të shoqërisë në Chania zënë një sipërfaqe prej 32.000 m².

Kapaciteti i linjës së re të prodhimit të fikseve të zjarrit dispozicion të **MOBIAK** i kalon 200 copë/orë. Sensori shumë i ndjeshëm i heliumit zbulon rrjedhje të mundshme të gazit shtytës për çdo fikse zjarri të prodhuar ose të riestuar. **MOBIAKFIRE** mund të tregtojë dhe prodhojë më shumë se 2000 produkte të ndryshme të gjitha të certifikuara sipas rregulloreve evropiane, standardeve evropiane dhe ndërkombëtare.

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se **MOBIAKFIRE** ka ekipin e vet të instaluesve të sistemit të fikjes dhe detektimit të zjarrit, i përbërë nga stafi i specializuar. Ekipi i teknikëve të **MOBIAK** kryen vlerësimet e sigurisë nga zjarri të objekteve dhe detektimin e zjarrit, riestimet dhe rimbushjen e fikseve të zjarrit, duke siguruar testimin hidrostatik të kontejnerëve me presion të lartë dhe të ulët. Ekipi i teknikëve është vazhdimisht në mbështetje të çdo bashkëpunëtori të **MOBIAK**, për çdo lloj instalimi hidraulik dhe elektrik në të gjithë Greqinë.

Gjithashtu, është e rëndësishme të përmendet përvetësimi i certifikatave shtesë, veçanërisht të kërkuara dhe të nevojshme për modele të ndryshme të fikseve të zjarrit, si SRPS (Serbi), NCP dhe KIWA (Holandë), TSE (Turqi), BENOR (Belgjikë), NF (Francë), VDS (Gjermani), CNBOP (Poloni), AS/NZS (Australi dhe Zelandë e Re) dhe UL/FM (Amerikë).

Për më tepër, **MOBIAK** është i certifikuar nga Regjistri Helen i Transportit, RINA, ABS dhe Regjistri Rus i Transportit për testimin e fikseve të zjarrit, aparateve të frymëmarrjes dhe sistemeve të sigurisë në anije. Në këtë aspekt ka zhvilluar bashkëpunim edhe me shoqëritë e transportit detar.



Seria kryesore e produkteve zjarrfikëse

- ▶ Fikëse zjarri portative dhe me rrota të të gjitha kategorive (me pudër, dyoksid karboni, shkumë për përdorim të përgjithshëm, shkumë me yndyrë dhe vaj gatimi, shkumë pa fluor, ujë, ujë të distiluar, mjegull uji, agjent të pastër, bateri litium-jon) certifikuar nga organe të njohura në rang ndërkombëtar
- ▶ Fikëse zjarri automatike të montuara në tavan me pluhur të thatë dhe agjent të pastër
- ▶ Gjenerator shkume me rrota
- ▶ Pjesë këmbimi dhe aksesore për të gjitha llojet e fikësve të zjarrit
- ▶ Agjentët për fikjen e zjarrit të të gjitha llojeve
- ▶ Lëngje rezistente ndaj zjarrit për aplikime të ndryshme
- ▶ Stenda në dysHEME dhe kabinete mbrojtëse për fikëset e zjarrit
- ▶ Kasë mbrojtëse për fikëset e zjarrit
- ▶ Rrotullues i tubit me ose pa mbështjellje
- ▶ Stacionet për pajisjet e zjarrit të llojeve të ndryshme
- ▶ Rrotullues i tubit të ujit me rrota
- ▶ Tuba për fikje zjarri, aksesore dhe koka rubineti të të gjitha llojeve
- ▶ Kova rëre të madhësive të ndryshme
- ▶ Çelësat me grep dhe pajisjet për stacionet zjarrfikëse
- ▶ Valvulat dhe hidrantët e rrjeteve të ujës jellësit të llojeve dhe Dimensioneve të Ndryshme
- ▶ Spërkatës uji të të gjitha llojeve
- ▶ Montimet e pompave të ujit të fikësve të zjarrit EN & NFPA dhe pompat e ujit lundruese
- ▶ Dyer rezistente ndaj zjarrit dhe dyer dhe pajisje të thjeshta metalike
- ▶ Pajisjet e zjarrfikësve - uniforma, aparatet e frymëmarrjes, çizmet etj.
- ▶ Maska dhe filtra të llojeve të ndryshme
- ▶ Shenjat e sigurisë & dritat e emergjencës
- ▶ Pllakat e emergjencës të montuara në mur
- ▶ Sirenë alarmi që mbahet në dorë & montohet në dysHEME
- ▶ Kuti të ndihmës së shpejtë të llojeve të ndryshme
- ▶ Barela & karrige me rrota të llojeve të ndryshme
- ▶ Pajisje ADR
- ▶ Pajisjet për detektimin e zjarrit (panele, detektorë, butona alarmi, sirena sinjalizuese, etj.)
- ▶ Batanije kundër zjarrit në madhësi dhe lloje të ndryshme
- ▶ Sisteme automatike të certifikuara për fikjen e zjarrit të të gjitha llojeve (HFC-227ea, FK-5-1-12, IG, CO2, kuzhina profesionale, pudër, shkumë, mjegull uji, etj.)
- ▶ Sistemi i certifikuar NOVEC që përdoret gjatë transportit
- ▶ Gjeneratorë të certifikuar me aerosol
- ▶ Pajisje për shuarjen e zjarrit të llojeve të ndryshme dhe detektor tymi për përdorim shtëpiak ose profesional
- ▶ Pajisjet për mbushje dhe të mirëmbajtjes për zjarrfikëset dhe sistemet e zjarrfikësve
- ▶ Anijet për stërvitje (për përdorim nga zjarrfikësit)
- ▶ Matës portativ të nivelit të ujit në bojler



MOBIAKCARE

Pajisje mjekësore

MOBIAKCARE, sektori mjekësor i **MOBIAK**, është një nga markat më të mëdha të shitjeve me shumicë që operon në Evropën Jugore. Shëndeti i individit përfshin në gamën e tij produkte që ndihmojnë në parandalimin e sëmundjeve, ndihma të përditshme për kujdesin nda pacientit, produkte të ndihmës së shpejtë, pajisje respiratore dhe mjekësore.

Shoqëria nisi aktivitetin e saj në vitin 1977 me prodhimin e oksigjenit mjekësor, duke mbuluar kështu nevojat e spitaleve si dhe terapinë me oksigjen në shtëpi. Prodhimi i oksigjenit mjekësor ndërtoi një themel të sigurt për shoqërinë duke sjellë zhvillimin e sektorit të saj tregtar dhe teknik me pajisje të specializuara për frymëmarrjen të teknologjisë më të fundit.

MOBIAKCARE ka përvojën, njohuritë dhe infrastrukturën e duhur, si dhe një rrjet mbarëbotëror për të mbështetur produktet dhe partnerët tanë. Ajo po zhvillon vazhdimisht gamën e saj me produkte të reja duke marrë parasysh gjithmonë kërkesat e tyre dhe duke i dhënë përparësi plotësisht të nevojave të tyre. Kjo u mundësua falë themelimit të një departamenti të ri të Kërkimit dhe Zhvillimit, kombinuar me përvojën e larmishme që zotëron. Qëllimi kryesor i departamentit është kërkimi i produkteve të reja dhe plotësimi i nevojave të veçanta të tregut. Këto studime me synim tregun ndihmojnë në zhvillimin e shoqërisë dhe në përmbushjen e kërkesave të çdo individi.

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se ai ofron një numër të konsiderueshëm të objekteve në: Aspropyrgos Attica (7000 m²), Selanik (5000 m²) dhe Kretë (Chania 32,000 m² – Heraklion 700 m²) me 3 pika shërbimi të pajisura mirë. Pikat e shërbimit, të cilat ndodhen në të gjithë vendin, janë të autorizuar nga shtëpitë evropiane në Greqi dhe kanë staf me teknikë të specializuar. Ata kanë krijuar mbi 20 laboratorë të gjumit, në Greqi dhe jashtë saj, në mënyrë që të mund të vërtetojnë besueshmërinë dhe përvojën e tyre në këtë fushë.

Shoqëria ka certifikimin nga organizata të njohura ndërkombëtare si standardi ISO 9001:2015 nga agjencia e vlerësimit për cilësinë për menaxhimin e cilësisë ABC, ISO14001:2015 nga certifikimi zviceran në lidhje me menaxhimin e mjedisit dhe ELOT ISO 45001:2018 nga EBETAM për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë.

MOBIAKCARE ka certifikime të tilla si ISO13485: 2016 nga qendra kombëtare për vlerësimin e cilësisë dhe teknologjisë në shëndetësi rreth menaxhimit të cilësisë së produkteve të teknologjisë mjekësore dhe në të njëjtën kohë përputhet me kërkesat e vendimit të Ministrisë ΔΥ86 / Γ.Π.οικ / 1348 / 2004 për trajtimin e pajisjeve të teknologjisë mjekësore . Përveç standardeve të mësipërme, të gjitha produktet kanë simbolin CE.

Angazhimi i shoqërisë drejt vizionit për produkte dhe shërbime me cilësi të lartë, si dhe qasja e saj e përqendruar te klientët, e çuan departamentin e pajisjeve mjekësore të **MOBIAK** drejt zhvillimit të shpejtë në Greqi dhe një nga shoqëritë evropiane me progresin më të shpejtë në këtë sektor.



Linja kryesore për produkte mjekësore

- ▶ Produkte ortopedike
- ▶ Karrige me rrota
- ▶ Pajisje të qendrës mjekësore
- ▶ Pajisje diagnostikuese dhe mjekuese
- ▶ Aparatura ndihmëse të specializuara për shpinën, krahët, këmbët dhe kokën / korse ortopedike
- ▶ Materiale mjekësore
- ▶ Mjete ndihmëse dhe pajisje spitalore
- ▶ Shtretër për kujdes në shtëpi
- ▶ Pajisje ndihmëse për lëvizje
- ▶ Produkte për frymëmarrjen
- ▶ Pajisje për terapinë me oksigjen
- ▶ Pajisje për diagnostikimin/trajtimin e çrregullimeve të gjumit
- ▶ Pajisje kundër apnesë
- ▶ Pajisje për frymëmarrjen (invazive, joinvazive)
- ▶ Artikuj për fizioterapi



MOBIAKGAS

GAZET INDUSTRIALE DHE MJEKËSORE

MOBIAKGAS është një tjetër sektor i rëndësishëm i shoqërisë. Në këtë departament të veçantë, bëhet prodhimi dhe ambalazhimi i lëngjeve dhe gazeve për përdorim mjekësor dhe industrial, duke ofruar sigurinë dhe njohuritë e nevojshme të kërkuara nga klienti i mirëfilltë dhe i informuar.

MOBIAK lëndët e para i kthen në formë të lëngshme (oksigen, dyoksid karboni, azot, argon), i ruan në kontejnerë kriogjenë dhe më pas merr përsipër mbushjen e tyre në depozita dhe enë të transportuese, për të plotësuar nevojat e klientëve të saj. **MOBIAKGAS** partnerët janë krejtësisht të ndryshëm dhe nga shumë sektorë, si spitalet dhe klinikat, kompanitë e ndërtimit, kompanitë e ushqimit dhe pijeve, ambientet frigoriferike, etj.

Që në vitet e para të themelimit të tij, **MOBIAK** ka marrë përsipër furnizimin me oksigjen të lëngshëm për spitalet në të gjithë Kretën. Në ambientet e saj ka depozita të oksigjenit të lëngshëm teksa përdor një rezervuar privat, duke siguruar një dërgesë të shpejtë dhe në të njëjtën kohë duke synuar gjithmonë ofrimin e shërbimit më të mirë për institucionet e kujdesit mjekësor.

Departamenti i Gazit MOBIAK investon vazhdimisht për të përmbushur nevojat kërkuese të tregut. Së fundmi është instaluar njësia për mbushjen e përzierjeve INERGEN në 300bar. Tashmë, me këtë investim, shoqëria ka mundësinë të ambalazhojë gazrat industrialë, si azoti dhe argoni si dhe përzierjet e tyre, në 300 bar (IG541, IG55, IG100).

Së fundi, qendra e ri-testimit të enëve përfshihet në departamentin e veçantë të shoqërisë. Kjo qendër është e testuar dhe e certifikuar nga EBETAM, ndërsa stafi i saj është i trajnuar me njohuri të shkëlqyera të legjislacionit përkatës.

MOBIAKGAS ofron shërbime të nivelit të lartë për të gjitha departamentet e shoqërisë e testeve hidrostatike për të gjitha llojet e enëve, prodhimin e sistemeve fikse të zjarrfikësve me presion të lartë, mbushje dhe testim të aparateve të frymëmarrjes, etj.

Linja kryesore e produkteve dhe shërbimeve të gazit

- ▶ Enë me gaze mjekësore dhe industriale
- ▶ Bombola me azot / Kontejnerë (N_2)
- ▶ Mbyllje të ndryshme
- ▶ Azoti (N_2), Argon (Ar), Acetilen (C_2H_2),
Dyoksid karboni (CO_2), Helion (He), Oksigjen (O_2)
Rregullatorët e presionit
- ▶ Enë me gaze mjekësore dhe industriale
- ▶ Ri-testimi dhe mirëmbajtja e enëve
- ▶ Kontrolli i cilësisë së gazeve dhe mundësia e lëshimit të certifikatave të konformitetit



MOBIAKTRAINERS

QENDRA E TRAJNIMIT

Departamenti edukimit dhe trajnimit i MOBIAK bazohet në strukturat shumë të organizuara të kërkimit dhe zhvillimit që shoqëria ka krijuar ndër vite, të ndërthura me përvojën dhe njohuritë e fuqisë punëtore të saj. Trajnimet standarde kryhen në hapësira të reja, moderne dhe produktive për partnerët në fushat e ekspertizës së saj dhe më gjerë.

Seminaret e trajnimit mbahen nga shoqëria në ambientet e saj ose jashtë ambienteve të saj qendrore, në të gjithë Greqinë. Vizioni origjinal i shoqërisë për krijimin e një qendre moderne trajnimi për sigurinë nga zjarri po merr një formë tjetër.

Që në vitin 2021, në objektet qendrore në Chania, Kretë, filluan të zhvillohen seminare, duke ftuar partnerë nga e gjithë Greqia për të diskutuar tema të ndryshme që lidhen me fushat e ekspertizës së shoqërisë. Gjithashtu, herë pas here në ambiente ftohen edhe partnerë nga jashtë, për të zhvilluar diskutime konstruktive për çështje të fushës përkatëse të **veprimtarisë së MOBIAK-ut**.

Krahas seminareve - takimeve të mësipërme dhe me avancimin e teknologjisë dhe produkteve të përditësuara vazhdimisht, vlen të theksohet se seminare të brendshme mbahen edhe nga organizata dhe institucione për trajnimin shtesë të **MOBIAK** në fushat e veprimtarisë së saj. Qëllimi i këtyre seminareve të brendshme është që **MOBIAK** të jetë në gjendje të ofrojë, nëpërmjet fuqisë punëtore, njohuritë dhe shërbimin maksimal të mundshëm për partnerët e tij, duke përbushur çdo nevojë të mundshme të tyre dhe duke ofruar zgjidhje të integruara cilësore.

Në vazhdimësi të përpjekjes së shoqërisë për të përmirësuar shërbimet dhe ofrimet e saj, **MOBIAK** ndjek teknologjitë dhe tendencat e reja dhe vazhdon të krijojë një qendër trajnimi pioniere, për standardet greke, e pajisur plotësisht me mjetet më të fundit të teknologjisë, për trajnimin në çdo incident zjarri. Jemi të vetëdijshëm se është jashtëzakonisht e rëndësishme që të gjithë të trajnohen siç duhet për pajisjet e zjarrfikësve dhe sigurinë ndaj zjarrit, në mënyrë që ata të jenë të përgatitur siç duhet për t'u përballur me çdo rrezik të mundshëm.

Seminaret e trajnimit zhvillohen për njerëzit që nuk kanë njohuri për përdorimin e pajisjeve zjarrfikëse si dhe zjarrfikësit profesionistë, duke paraqitur skenarë realistë gjatë trajnimit në mënyrë që grupet të kryejnë trajnime të sigurta në zona të ndryshme. Kjo qendër trajnimi moderne është subjekt i zhvillimit të vazhdueshëm dhe së shpejti do të jetë në dispozicion për të gjithë për një trajnim modern, të larmishëm dhe gjithëpërfshirës.



MOBIAKRECYCLE

QENDRA E RICIKLIMIT

Duke qenë e ndërgjegjshme dhe e vetëdijshme për mjedisin dhe duke reflektuar mbi efektin e veprimeve të çdo personi mbi të, shoqëria përpiqet vazhdimisht të reduktojë gjurmën e saj mjedisore.

Është e rëndësishme të theksohet se **MOBIAK-u**, duke respektuar gjithmonë legjislacionin dhe udhëzimet e rregulloreve, ndjek prioritizimin e duhur të menaxhimit të mbetjeve duke pasur si objektiv kryesor mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve.

Në kuadër të ndërgjegjësisë më të gjerë ekologjike dhe përgjegjësisë më të madhe mjedisore, **MOBIAK-u** inkurajon vazhdimisht kryerjen e proceseve të riciklimit dhe menaxhimit të mbetjeve që prodhon. Më konkretisht, duke bashkëpunuar me shoqëri të specializuara të riciklimit dhe menaxhimit të mbetjeve, ka vijuar me menaxhimin e mbetjeve të mëposhtme:

Plastikë (ambalazhe dhe kapakë plastik), qelq (shishe dhe ambalazhe qelqi), ambalazh letre ose kartoni, bateri, llamba, kontejnerë boje dhe toneri, paleta druri, mbetje pajisjesh elektrike dhe elektronike, metale (alumin, bronz, bakër), metale me ngjyra, pluhur për shuarjen e zjarrit.

Shoqëria ka filluar të mbushë një boshllëk që ekzistonte dhe po shqetësonte sektorin e zjarrfikësve. Pas marrjes së Lejes Panhelenike për Grumbullimin dhe Transportin e Mbetjeve, MOBIAK-u tashmë është në gjendje të marrë dhe menaxhojë pluhurin që shuan zjarrin që prodhohet gjatë proceseve të mirëmbajtjes së fikësve të zjarrit në laboratorët përkatës, si dhe ta asgjësojë në shoqërinë kompetente administruese.


Gjithashtu, duke pasur licencën për proceset e trajtimit të mbetjeve brenda ambienteve të saj, shoqëria është në gjendje të ndajë pjesët e fikësve të zjarrit dhe më vonë t'i menaxhojë dhe asgjësojë ato. Prandaj, përveç pjesës tjetër të certifikimeve, **MOBIAK-u** me të drejtë ka siguruar dhe mban edhe certifikimin sipas ISO 14001:2015 për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor që aplikon.

Shoqëria është zotuar që të vazhdojë përpjekjet për një të ardhme më të pastër, duke reduktuar gjithnjë e më shumë gjurmën e saj mjedisore, duke kontribuar në mënyrën e vet për mbrojtjen e mjedisit.





Duke pasur në dispozicion burime njerëzore prej më shumë se 200 personash dhe makineri të teknologjisë së fundit, MOBIAK-u garanton produkte dhe shërbime me cilësi të lartë.



Përkushtimi i shoqërisë ndaj vizionit fillestar për cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të saj, ka bërë që **MOBIAK-u** të renditet **në vend të 1-rë në Greqi** dhe si një nga shoqëritë evropiane me rritjen më të shpejtë në këtë sektor.



 **+30 28210 63222**
www.mobiak.com

 **www.mobiak.com**
info@mobiak.com





YEARS
OF EXPERIENCE MOBIAK S.A.
1977 - 2023

www.mobiak.com

